

VENDIM
Nr. 25, datë 20.1.2016

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 954, DATË 5.9.2012, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E FONDIT TË EKONOMISË KREATIVE
(ARTIZANATI)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, 5, 6, 7, 8 e 9, të ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 954, datë 5.9.2012, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i fundit i pikës 4 riformulohet, si më poshtë vijon:

“Nuk përfitojnë nga ky fond sipërmarrjet të cilat kanë përfituar nga fonde të akorduara nga donatorët apo institucionet financiare ndërko-mbëtare për të njëjtin projekt.”.

2. Pika 5 riformulohet, si më poshtë vijon:

“5. Projektet që për zgjidhen nga sektori i artizanatit mbulojnë fushat e mëposhtme:

a) Zhvillimin e produkteve të reja;

b) Blerjen e pajisjeve për nxitjen e prodhimit;

c) Marketingun e produktit;

ç) Kualifikimin dhe ndërtimin e kapaciteteve menaxheriale të ndërmarrjes aplikuese.”.

3. Shkronjat “ç” dhe “e”, të pikës 6, shfuqizohen.

4. Pika 7 shfuqizohet.

5. Emërtimi “Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës” zëvendësohet me “Ministri përgjegjës për ekonominë”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama